

Themelimi i Rrjetit jo-formal të organizatave të shoqërisë civile për integritime evropiane

Duke pasur parasysh rolin shumë të rëndësishëm të komunave si zbatues të reformave si dhe rolin e pazëvendësueshëm të organizatave të shoqërisë civile në proces të integritimit evropian, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit Evropian (MIE) dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKM), në mbështetje të projektit të GIZ 'Përkrahje në procesin e integritimit evropian', dëshiron të themeloj një *Rrjet jo-formal* të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) të nivelit lokal.

Qëllimi i themelimit të këtij Rrjeti jo-formal është që të organizohet shoqëria civile në nivel lokal për të zhvilluar partneritet me autoritetet lokale në avancimin e agjendës evropiane të Kosovës. Në këtë drejtim, Rrjeti pritet të:

- ketë qasje gjithëpërfshirëse, me ndjeshmëri gjinore dhe etnike, për të bashkëpunuar me organet komunale në procesin e integritimit evropian;
- zhvilloj partneritet me Zyrtarët Komunal për Integritime Evropiane
- merr pjesë aktive në proceset komunale për të siguruar mbështetjen e shoqërisë civile
- ushtroj rolin e monitoruesit të organeve komunale në zbatim të veprimeve që derivojnë nga Plani i veprimit të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës;
- promovoj transparencën komunale duke publikuar në media lokale dhe kombëtare të arriturat dhe ngecjet e komunave në proces të integritimit evropian
- ofroj këshilla dhe rekomandime komunave në përmirësimin e performancës në proces të integritimit evropian
- bashkëpunoj dhe promovoj shkëmbimin e praktikave mes anëtarëve të Rrjetit dhe komunave të tyre përkatëse në funksion të përmirësimit të performancës
- ofroj rekomandime dhe mendime këshillëdhënëse për ministritë dhe institucionet tjera të Republikës së Kosovës në lidhje me integritimin evropian;

Rrjeti apo anëtarët e Rrjetit, me zhvillimin e procesin do të kenë mundësinë të zhvillojnë edhe potencialin e vet si pikë referimi për integritime evropiane në komunë nga e cila vijnë. Poashtu me njohjen e procesit të integritimit evropian dhe specializimit në fushën e veprimit do të zhvillojnë potencialin për tu bërë pjesë skemave të ndryshme që mbështesin integritimin evropian.

Rrjeti synon të përfshijë pjesëmarrjen e OSHC-ve të fushave të ndryshme të veprimit, prandaj nuk është i kufizuar me numër të anëtarëve. Megjithatë MAPL synon që në këtë Rrjet të jenë të përfshira vetëm OSHC-të që veprojnë në nivel të komunës, dhe në këtë drejtim do të tentoj të krijoj përfaqësim të balancuar të anëtarëve duke pasur parasysh përfaqësimin territorial/komunal, etnik, gjinor, etj.

Për të përzgjedhur përfaqësuesit, MAPL fton të gjitha OSHC-të lokale të regjistruara në Kosovë për të konkurruar për anëtarësim në Grupin Punues.

Kandidatët nga OSHC duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Një biografi të kandidatit/ës;
2. Dëshmi për kualifikimet profesionale;
3. Certifikatën e regjistrimit të organizatës.

|||||